SEANCA E 22-TË E KE TË LSHPM-së

REZULTATET E ARRITURA NXITJE PËR AKTIVITETE TË REJA

Duhet të jemi të kënaqur nga rezultatet. Nga ana tjetër, rezultatet e arritura janë nxitje për aktivitete të reja në vitin 2019. Aktivitetet e realizuara tregojnë që Programi i vitit 2018 i LSHPM-së është realizuar në tërësi, dhe më shumë se aq

Shkup, 20 mars - Më 5 mars të vitit 2019, Këshilli ekzekutiv i LSHPM-së e mbajti seancën e saj të 22-të me të cilën udhëhoqi kryetari i Lidhjes Dragi Argirovski, ndërsa krahas anëtarëve të KE-së, morën pjesë edhe kryetari i Kuvendit të LSHPM-së, Besnik Pocesta, kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, Mitre Stojanovski, kryetari i Forumit juridik-ekonomik, d-r Fidanço Stoev, kryetari i Komisionit për bashkëpunim ndërkombëtar, Shaban Azizi, kryetari i komisionit për sport dhe rekreacion, Zdravko Petkovski, kryetari i Komisionit për shëndetësi dhe politikë sociale, d-r Stojançe Stefanoski dhe kontabilisti i Lidhjes, Petar Andreevski.

Pasi u miratua procesverbali nga seanca e 21-të e mëparshme e KE-së të LSHPM-së, në rendin e ditës ishte Raporti i punës së LSHPM-së dhe organeve dhe trupave të saj në vitin 2018, të cilin e shpjegoi Saltir Karovski, nënkryetar i KE të LSHPM-së.

"Në Raportin e punës së LSHPM-së për vitin 2018 janë të përfshira të gjitha aktivitetet më të rëndësishme, rezultate të veçanta janë arritur në përmirësimin e standardit të pensionistëve, mbrojtjes shëndetësore, aktiviteteve kulturore dhe sportive, bashkëjetesa ndërkombëtare dhe ndëretnike dhe të tjera. Duhet të jemi të kënaqur nga rezultatet. Nga ana tjetër, rezultatet e arritura janë nxitje për aktivitete të reja në vitin 2019. Aktivitetet e realizuara tregojnë që Programi i vitit 2018 i LSHPM-së është realizuar në tërësi, dhe më shumë se aq", theksoi mbi të gjitha Karovski.

Në seancë anëtarët e Këshillit Ekzekutiv ishin të informuar edhe për punën financiare të LSHPM-së për vitin 2018. Shpjegim profesional të materialit të mëparshëm të distribuuar dha kryetari i Këshillit mbikëqyrës, Mitre Stojanovki, i cili theksoi që sipas Raportit financiar të parashtruar të cilin e shqyrtoi Këshilli mbikëqyrës, analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve të shfaqura tregon që LSHPM ka punuar sipas ligjeve, me kujdes dhe në mënyrë racionale.

Pas debateve të cilat vijuan pas këtyre dy dokumenteve të rëndësishme të njëjtat u miratuan së bashku me vërejtjet e dhëna. Në seancë u miratua edhe Propozim - Vendimi për llogarinë përfundimtare të Lidhjes për vitin 2018.

Në seancë u soll vendimi i nikoqirëve të Revyve të teta rajonale të këngëve, muzikës dhe lojërave do të jenë shoqatat e pensionistëve: Vinicë, Tetovë, Pensionistët e luftës, Qendër, Vevçani, Vallandovë, Prilep dhe Sveti Nikolle. Të gjitha shoqatave LSHPM do t'u shpërndajë nga 40 000 denarë për përgatitje më të suksesshme të revyve, të cilat do të mbahen në periudhën nga 1 prill deri më 20 maj 2019, ndërsa Revyja republikane do të mbahet në fillim të muajit qershor 2019. Gjithashtu, u përcaktuan edhe shoqatat nikoqire të garave të 24-ta sportive në 8 rajone edhe atë: SHPL, Gostivar, Krushevë, Strugë, Gjevgjeli, Zletovë, Radovish, Konçe dhe Berovë. Edhe nikoqirët e garave rajonale sportive do të marrin nga 40 000 denarë, ndërsa do të mbahen në periudhën prej 20 maj deri më 31 qershor 2019. Në seancën e fundit nga kjo përbërje, u soll vendim që kryetarit Dragi Argirovski t`i jepet "Pllaka e artë" për kontribut të veçantë në zhvillimin dhe punën e Lidhjes.

Kalina S. Andonova

AKTIVITETI NDËRKOMBËTAR I LSHPM-së

Nënshkruhet Memorandum për bashkëpunim me pensionistët e Kosovës

Shkup, 20 mars - Delegacioni i Lidhjes së shoqatave të pensionistëve dhe invalidëve të punës së R. Kosovës më 28 shkurt të vitit 2019 realizoi vizitë zyrtare në Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Në delegacionin e Lidhjes nga Kosova ishte kryetari, Shaban Kajtazi, sekretari, Hasan Berisha dhe kryetarja e Aktivit të grave -pensioniste të Prishtinës, Suvela Kasami. Delegacionin e priti kryetari i LSHPM-së, Dragi Argirovski së bashku me Besnik Pocestën, kryetar i Kuvendit të Lidhjes, Saltir Karovki, nënkryetar i Bordit ekzekutiv dhe Stanka Trajkova sekretar i Bordit ekzekutiv të LSHPM-së. Pastaj kryetarët e të dy lidhjeve në hapësirat e LSHPM-së zyrtarisht nënshkruan Memorandum për bashkëpunim me çka përzemërsisht u përshëndet nga të gjithë të pranishmit e takimit. Njëkohësisht u shkëmbyen Monografi të të dy lidhjeve dhe materiale të tjera për njoftim më të mirë mes tyre. Në takim ishte theksuar që bashkëpunimi ndërkombëtar i LSHPM-së është aktivitet programor me rëndësi për realizimin e qëllimeve për avancim të jetesës së pensionistëve me dinjitet. Bashkëpunimi i shoqatave të pensionistëve nga të dy vendet zhvillohet prej shumë vitesh përmes komunikimit të ndërsjellë, vizitave dhe shoqërimit. Me nënshkrimin e Memorandumit pritet që bashkëpunimi ndërmjet lidhjeve dhe shoqatave të intensifikohet. Gjatë vizitës në LSHPM u zhvilluan bisedime për çështjet organizative, programore dhe financiare në të dyja lidhjet. Mysafirët theksuan që në Lidhjen e pensionistëve dhe invalidëve të punës së Kosovës, prej gjithsej 165.000, vetëm 61.000 janë pensionistë të vjetër dhe pensionet, varësisht nga lloji i arsimit të pensionistit, lëvizin prej 180 deri 265 euro, në kategori sipas nivelit të arsimit. Për të gjithë pensionistët dhe invalidët e punës, anëtarësia është dy euro. Në fund, mysafirët dërguan ftesë për vizitë në Prishtinë, për përcaktimin e aktiviteteve të reja konkrete.

M-r Ilija Gligorov

BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR I LSHPM-së

INTENSIFIKOHEN MIQËSIA DHE BASHKËPUNIMI SHUMËVJEÇAR

Me Lidhjen e pensionistëve të Sllovenisë bashkëpunojmë tashmë 10 vite. Ky është një jubile i llojit të vet i bashkëpunimit tonë, i cili u shëndrrua në miqësi të vërtetë dhe të sinqertë

Shkup, 20 mars - Më 13 mars 2019, delegacioni i pensionistëve të Republikës së Sllovenisë, ZDUS, në përbërje: Marjan Shiftar dhe Andrej Jus, kryetarë të Këshillit programor të Festivalit për gjeneratën e tretë, Janez Levec dhe Melita Remshkar drejtorë të organizatës "Prevent", Tihomir Kovaçiç, drejtor ekzekutiv i "Proevent" dhe Vanja Sitar, udhëheqës i Projektit Festivali për gjeneratën e tretë, ishin në vizitë në LSHPM-së. Në objektet e Lidhjes, delegacionin e priti Kryetari i LSHPM-së, Dragi Argirovski, ndërsa në takim morën pjesë: Besnik Pocesta, kryetar i Kuvendit të LSHPM-së, Saltir Karovski, nënkryetar i KE të LSHPM-së, Stanka Trajkova, sekretare e KE të LSHPM-së dhe Kalina S. Andonova, kryetare e Komisionit për informim në Lidhje.

Të pranishmëve i pari ju drejtua dhe ju uroi mirëseardhje të ngrohtë, kryetari i LSHPM-së, Dragi Argirovski, i cili ndër të tjerash theksoi, "Me Lidhjen e pensionistëve të Sllovenisë bashkëpunojmë tashmë 10 vite. Ky është një jubile i llojit të vet i bashkëpunimit tonë, i cili u shëndrrua në miqësi të vërtetë dhe të sinqertë. Në vitet e kaluara, udhëheqësit e dy Lidhjeve punuan në përmbushjen e interesave të pensionistëve në të dy vendet. Më intensiv ishte bashkëpunimi i planit kulturor përmes pjesëmarrjes së shoqatave të pensionistëve anëtare të LSHPM-së në Festivalin ndërkombëtar folklorik për gjeneratën e tretë. ZDUS na ka ndihmuar në çdo pikëpamje dhe çdo nivel. Duke iu falënderuar asaj, shoqatat dhe pensionistët nga vendi ynë e afirmuan pasurinë tonë kulturore, kulturën dhe traditën në Republikën e Sllovenisë dhe më gjerë, për arsye se në këtë festival prestigjioz marrin pjesë më shumë vende nga Ballkani, por edhe nga Evropa. Shpresojmë në bashkëpunim më intensiv në të ardhmen, veçanërisht në mbështetjen dhe ndihmën e tyre në realizimin e idesë sonë për mbajtjen e Revysë folklorike të Ballkanike në Shkup".

Pastaj Argirovski i njoftoi anëtarët e delegacionit me aktivitetet e Lidhjes në periudhën e fundit. Duke u falënderuar për mikpritjen e ngrohtë, Marjan Shiftar u shpreh, "Së pari dua të jua përcjell përshëndetjet e të gjithë atyre që deshën të vijnë në Maqedoni, por për arsye objektive nuk erdhën. Gjithashtu, e shfrytëzoj rastin dhe dua ta shfaqi kënaqësinë tonë që takohemi me ju, bashkëpunëtorët dhe miqtë tanë shumëvjeçar. 10 vite nuk është periudhë e shkurtë. Pjesëmarrja juaj në Festivalin për gjeneratën e tretë gjithmonë ka qenë e dukshme dhe e bukur. Edhe në të ardhmen do të ju ndihmojmë në çdo plan, në kufijtë e mundësive tona dhe përvojës sonë, duke lobuar në nivelin më të lartë tek ambasadorët tanë". Pastaj ai foli për aktivitetet e pensionistëve sllovenë të cilët me numër janë mbi 600 000, për zhbllokimin e pensioneve të cilat kanë qenë të bllokuara rreth 4 vite, për harmonizimin e tyre dhe të tjera, duke potencuar që bashkëpunimi duhet të zgjerohet me përmbajtje dhe forma tjera, me organizim të vizitave dhe ekskursioneve mes pensionistëve dhe gjëra të tjera tjera.

Kalina S. Andonova